

VENDIM
Nr.671, datë 10.10.2007

PËR DHËNIE FONDI KRYQIT TË KUQ SHQIPTAR, PËR PROMOVIMIN E DHURIMIT
VULLNETAR TË GJAKUT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar dhe të nenit 13 të ligjit nr.9739, datë 21.5.2007 “Për shërbimin e transfuzionit të gjakut në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kryqit të Kuq Shqiptar t’i jepet fondi prej 5 000 000 (pesë milionë) lekësh, për promovimin e dhurimit vullnetar të gjakut.
 2. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2007, zëri “Shpenzime për mallra e shërbime”, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë (Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut).
 3. Ngarkohen Ministri i Shëndetësisë Ministri i Financave dhe Presidenti i Kryqit të Kuq Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha